

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6358
E enjte, 8 korrik 2021
çmimi 0.40 €

Wesley Clark: Kosova ka bërë përparim mbresëlënës drejt demokracisë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NË MOSHËN 94 VJEÇE KA NDËRRUAR JETË BABAI I KADRI VESELIT

FAQE 3

I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT BABAIT TË KADRI VESELIT



Fazli Veseli, babai i ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka ndërruar jetë në moshën 94 vjeçe. Ai është varrosur të mërkurën në vendlindjen e tij, në fshatin

Broboniq të Mitrovicës. Personalitete të ndryshme institucionale dhe partiake kanë ngushëlluar Kadri Veselin për vdekjen e babait. Me këtë rast, ata

kanë vlerësuar lart kontributin e bacës Fazli dhe të familjes së tij. Ata kanë thënë se baca Fazli i ka edukuar fëmijët e tij me dashurinë për atdheun

AKTUALE



KUVENDI I KOSOVËS MIRATON REZOLUTË PËR GJENOCIDIN NË SREBRENICË F. 5

OSMANI: PJESËMARRJA E GRAVE NË POLITIKË, SHTYLLË KRYESORE E DEMOKRACISË F. 6

KURTI TAKON SHEFIN E OSBE-SË, BISEDOJNË PËR ZGJEDHJET LOKALE F. 6

PKD-ja E DËRGON NË KUSHTETUESE VENDIMIN PËR SHKARKIMIN E ANËTARËVE TË KPMSHCK-së F. 7

EKONOMI



PRITET RITJE E THEKSUAR E ÇMIMEVE TË DERIVATEVE TË NAFTËS NË KOSOVË F. 8

POSTA E KOSOVËS: JEMI NË SHËRBIM TË KONSUMATORËVE F. 8

F. 8

KURTI KRITIKON MARRËVESHJEN E UASHINGTONIT, OPOZITA KËRKON ZBATIMIN E SAJ



Subjektet opozitare i kanë kërkuar kryeministrit Albin Kurti që ta zbatojë marrëveshjen e Uashingtonit, ndërsa i pari i qeverisë ka kritikuar disa pika të kësaj marrëveshjeje. Kryeministri Kurti ka akuzuar ish-kryeministrin

Hoti që e ka nënshkruar atë marrëveshje, duke thënë se ka bërë veprim antikushtetues kur është zotuar për moratoriumin njëvjeçar të mosaplikimit në organizata ndërkombëtare

FAQE 4-5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

320 PUNËTORËVE TË TELEKOMIT U NDËRROHEN POZITAT, SINDIKATA PARALAJMËRON PADI F. 8

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vritet presidenti i Haitit

PORT-AU-PRINCE, 7 KORRIK - Presidenti i Haitit, Jovenel Moise, është vrarë në një sulm në shtëpinë e tij, ka bërë me dije kryeministri i përkohshëm i këtij vendi.

Claude Joseph ka thënë se rezidenca e presidentit në Port-au-Prince është sulmuar nga persona të pafunditë. Zonja e Parë është raportuar të jetë plagosur në sulm.

Joseph ka thënë se “janë marrë të gjitha masat për ta garantuar qëndrueshmërinë e shtetit”.

Moise, 53 vjeç, ka qenë në pushtet qysh në shkurt të vitit

2017, kur paraardhësi i tij, Michel Martelly, ka dhënë dorëheqje. Ai është përballur me akuza për korrupsion dhe është sfiduar nga disa protesta antiqeveritare.



Gjykata Supreme në Shkup shqyrton ankesën për rastin e Kumanovës

SHKUP, 7 KORRIK - Gjykata Supreme e Maqedonisë së Veriut ka nisur të mërkurën seancën publike lidhur me ankesën e palës mbrojtëse ndaj gjykimit të 33 personave për rastin e Kumanovës. Më 9 dhe 10 maj të vitit 2015 në Kumanovë kishte ndodhur një përlëshje e armatosur në mes të forcave maqedonase të sigurimit dhe një grupi që paraqitej si ish-Ushtria Çlirimtare Kombëtare.

Gjatë luftimeve që zgjatën dy ditë, ishin vrarë tetë pjesëtarë të policisë dhe dhjetë anëtarë të grupit të armatosur, që ishte pozicionuar në Lagjen e Trimave në këtë qytet, për t'ua tërhequr vëmendjen autoriteteve për, siç është thënë, shkeljen e të drejtave të shqiptarëve.

Për veprën penale “terrorizëm”, Gjykata Penale e Shkupit, më 2 nëntor të vitit 2017, shtatë

persona të grupit i dënoi me burgim të përjetshëm, 13 u dënuan me nga 40 vjet burgim, gjashtë me nga 20, një me 18, dy me nga 14, dy të tjerë me nga 13 dhe dy me nga 12 vjet burgim.

Shumica e grupit të gjykuar janë shtetas të Kosovës.

Në korrik të vitit 2019 vendimi u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit. Pala mbrojtëse tani kërkon përsëritjen e gjykimit, për shkak të, siç thotë, shkeljes së procedurës së gjykimit dhe mosrespektimit të kërkesës për paraqitjen e më shumë dëshmitarëve, përfshirë drejtuesit e lartë të policisë sekrete, të cilët, sipas palës mbrojtëse, kanë inskenuar gjithë rastin.

Pala mbrojtëse ka kërkuar edhe hetim ndërkombëtar të rastit, pasi pretendon se gjykimi i grupit të armatosur është i motivuar politikisht dhe me prapavijë etnike.

Në vitin 2019, pas zgjedhjes



president i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski ka premtuar një rishqyrtim të ngjarjeve të Kumanovës. Në këtë

kuadër, Agjencia e Inteligjencës Shtetërore ka bërë me dije se ka informata se pas incidentit mund të ketë pasur motive

politike dhe financiare, por detaje të tjera nuk janë dhënë, për të mos dëmtuar, siç është thënë, procesin e hetimeve.

Blinkeni takon virtualisht disa myslimanë ujgurë



UASHINGTON, 7 KORRIK - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, është takuar virtualisht me shtatë myslimanë ujgurë, përfshirë disa që ishin ndaluar në kampet e internimit në Kinë, për t'i dëgjuar përvojat e tyre. Departamenti i Shtetit ka thënë se Blinkeni dëshironte të dëgjonte drejtpërdrejt nga ish-të ndaluarit, të afërmit e tyre dhe avokatët e ujgurëve.

Kina është nën presion ndërkombëtar për ndalimin e më shumë se një milion ujgurëve dhe pakicave të tjera myslimane në kampe internimi në rajonin veriperëndimor të Ksinjiangut.

Kina këmbëngul se kampet janë “qendra të aftësimi profesional”, që synojnë t'i ndihmojnë njerëzit të largohen nga terrorizmi.

Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Ned Price, ka thënë se Blinkeni dëshironte të dëgjonte drejtpërdrejt nga grupi për kushtet me të cilat përballet komuniteti ujgur. “Sekretari ka vlerësuar se është e rëndësishme të takohet me këta individë për t'i dëgjuar nga afër historitë e tyre, për t'i dëgjuar nga afër përshtypjet e tyre për mizoritë e vazhdueshme në Ksinjiang dhe internimin e një milion

ujgurëve”, ka thënë Price.

Ai ua ka rikujtuar se administrata e presidentit amerikan, Joe Biden, dhe e paraardhësit të tij, Donald Trump, e kanë cilësuar fushatën në Ksinjiang si “gjenocid” dhe kanë vendosur sanksione ndaj Kinës për shkelje të të drejtave të njeriut. “Amerika ka folur shumë qartë për abuzimet, për mizoritë, për gjenocidin e vazhdueshëm që po ndodh në Ksinjiang”, ka thënë Price.

Qeveria kineze, mes të tjerash, është akuzuar për sterilizimin e grave ujgure dhe ndarjen e fëmijëve nga familjet e tyre.

Lofveni rizgjedhet kryeministër i Suedisë

STOKHOLM, 7 KORRIK - Kryetari i Partisë Socialdemokrate të Suedisë, Stefan Lofcen, është rizgjedhur kryeministër i këtij shteti të mërkurën, vetëm dhjetë ditë pasi kishte dhënë dorëheqje me rastin e humbjes së mocionit të mosbesimit. Lofveni më 28 qershor kishte dhënë dorëheqje nga posti i

kryeministrit, pasi e kishte humbur mocionin e votëbesimit. Sidoqoftë, deputetët i kanë dhënë vota të mjaftueshme të mërkurën për ta formuar qeverinë e re. Kryeministri i vjetër dhe i ri i Suedisë tani duhet të sigurojë përkrahje të shumicës për ta miratuar buxhetin. Ai ka thënë

se do të japë përsëri dorëheqje nëse nuk arrin ta bëjë këtë deri në vjeshtë, shkruan “Reuters”. Ai ka udhëhequr një qeveri të brishtë të pakicës që nga zgjedhjet e vitit 2018, të cilat i ndanë ulëset në Kuvend pothuajse në dy pjesë të barabarta dhe ofruan rritje për demokratët suedezë, të cilët

janë kundër imigrantëve.

Përderisa votimi i qeverisë së re shihej si proces që do të sillte rezultat shumë të ngushtë, Lofveni kishte pritur që ta shmangte rastin kur shumica voton kundër tij. Në fund, ai e ka shmangur refuzimin nga deputetët për vetëm dy vota në Kuvendin me 349 ulëse.



KA NDËRRUAR JETË, NË MOSHËN 94-VJEÇARE, BABAI I KADRI VESELIT

I jepet lamtumira e fundit babait të Kadri Veselit

Fazli Veseli, babai i ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka ndërruar jetë në moshën 94-vjeçare. Ai është varrosur të mërkurën në vendlindjen e tij në fshatin Broboniq të Mitrovicës. Personalitete të ndryshme institucionale dhe partiake kanë ngushëlluar Kadri Veselin për vdekjen e babait të tij. Me këtë rast, ata kanë vlerësuar lart kontributin e bacës Fazli dhe familjes së tij. Ata kanë thënë se baca Fazli i ka edukuar fëmijët me dashurinë për atdheun

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 KORRIK - Të mërkurën ka ndërruar jetë në moshën 94-vjeçare Fazli Veseli, babai i Kadri Veselit, i cili është varrosur në varrezat e fshatit të tij të lindjes, në Broboniq të Mitrovicës. Në varrimin e bacës Fazli kanë marrë pjesë familjarë, qytetarë dhe personalitete të jetës politike dhe ushtarake. Me këtë rast, familja Veseli, konkretisht Kadri Veseli, i cili gjendet në Hagë, ka pranuar ngushëllime për vdekjen e babait të tij. Fillimisht, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, e ka ngushëlluar familjen e Kadri Veselit për humbjen e bacës Fazli. "Në emër të Kuvendit të Kosovë po i shpreh ngushëllime familjes Veseli, të babait të tyre dhe të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli", ka thënë Konjufca. Edhe kryetari i sapozgjedhur i PDK-së, Memli Krasniqi, ka ngushëlluar familjen e ish-kryetarit të kësaj partie, duke thënë se mendjet dhe zemrat e tyre janë pranë Kadri Veselit në Hagë dhe familjes Veseli në Mitrovicë. "Lamtumirë, baca Fazli! Me dhimbje të thellë morëm lajmin për vdekjen e Fazli Veselit, babait të kryetarit

Kadri Veseli. Baca Fazli ishte një burrë që gati gjatë një shekulli jetë, secilën ditë ia kushtoi Kosovës. Si baba ai rriti dhe edukoi të gjithë fëmijët e tij në frymën atdhetare. Si shqiptar sakrifkoi dhe dha gjithçka nga vetja për lirinë e vendit tonë. Prandaj, sot, mendjet dhe zemrat tona janë pranë kryetarit Veseli në Hagë dhe familjes Veseli në Mitrovicë. Në emrin tim dhe të Partisë Demokratike të Kosovës, ngushëllimet më të thella. Pusho i qetë, baca Fazli!", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, i ka dërguar telegram ngushëllimi familjes Veseli me rastin e ndarjes nga jeta të babait të ish-kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli. Në telegramin e ngushëllimit, Abdixhiku ka thënë se në këtë kohë dhe çaste të vështira për familjen Veseli, vdekja e kryeplakut Haxhi Fazli Veseli është një dhimbje e madhe për familjen, miqtë dhe të afërmit e tyre.

"E nderuar familje Veseli, me keqardhje morëm lajmin për ndarjen nga jeta të prindit tuaj, Fazli Veseli. Ndajmë dhe bashkëndiejmë dhimbjen tuaj. Fazli Veseli i takon një gjenerate baballarësh që rritën dhe edukuan fëmijët e tyre në kohë



dhe rrethana shumë të vështira, duke i rritur me idealin për t'i shërbyer vendit deri në arritjen e lirisë. Në kohë dhe momente të vështira për familjen Veseli, vdekja e kryeplakut Haxhi Fazli Veseli është një dhimbje e madhe për familjen, miqtë dhe të afërmit e tyre. Në emrin tim dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes dhe të gjithë atyre që e njohën Fazli Veselin", ka thënë Abdixhiku. Ngushëllime familjes Veseli i ka shprehur edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se vdekja e bacës Fazli vjen në një çast të rëndë për familjen Veseli për shkak të rrethanave tanimë të njohura. "Pikëllues lajmi për ndarjen nga jeta të Fazli Veselit, babait të luftëtarit të orëve të para, bashkëthemeluesit të UÇK-së, ish-kreut të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Baca Fazli iku nga kjo botë duke lënë mbrapa një jetë të tërë me sfida. Vdekjet nuk janë të lehta, pavarësisht prej moshës, por vdekja e bacës Fazli vjen në një çast të rëndë për familjen Veseli për shkak të rrethanave tanimë të njohura. Sot ndaj dhembjen me mikun e bashkëluftëtarin tim Kadriun dhe mbarë familjen Veseli! Baca Fazli u prehtë në paqe!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj,

ka reaguar pas vdekjes së babait të Kadri Veselit. Në emër të Nismës Socialdemokrate, ai i ka shprehur ngushëllime familjes Veseli, miqve dhe të gjithë dashamirëve të të ndjerit. "Me pikëllim të madh morëm lajmin për ndarjen nga jeta të bacës Fazli Veseli, babait të bashkëluftëtarit tim, Kadri Veseli, që aktualisht ndodhet në Hagë, në mbrojtje të luftës sonë çlirimtare. Bacën Fazli do ta kujtojmë si një burrë të urtë e bujar, që rrjedhë nga një familje atdhetare, që në çdo periudhë të rëndësishme për vendin, kanë qenë në ballë të kontributit për të mirën e atdheut. Në emrin tim dhe të Nismës Socialdemokrate, i shpreh ngushëllime familjes Veseli, miqve dhe të gjithë dashamirëve të të ndjerit", ka thënë Limaj.

Baca Fazli kohën e fundit ka pasur probleme shëndetësore, ka qenë i shtrirë në spital. Gjatë kohës sa ka qenë në spital, bacën Fazli e ka vizituar edhe Kadri Veseli, i cili është lejuar nga Gjykata Speciale që ta bëjë një vizitë të tillë.

Hoxhaj për babanë e Veselit: I edukoi fëmijët për atdhedashurinë

Fazli Veseli, babai i ish-kryeparlamentarit Kadri Veseli, ka vdekur të mërkurën në mëngjes. Enver Hoxhaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar për takimin e fundit me babanë e Kadri Veselit. Hoxhaj ka treguar se herën e fundit kur e ka takuar ka qenë pak ditë pasi Kadri Veseli ishte nisur për Hagë dhe se babai i ish-kryeparlamentarit ia shtrëngoi dorën në shtëpinë e tij në Mitrovicë. Po ashtu, ka treguar se ishin fjalët e tij që e motivuan se duhet t'i mbledhim forcat dhe dhimbjen të kthejmë në energji për të vazhduar punën e kryetarit Veseli në shtetndërtimin e Kosovës.

"I paska mbyllur sytë përjetësisht babai i Kadriut, Fazli Veseli! Herën e fundit kur e takova, pak ditë pasi Kadri ishte nisur për në Hagë, ma shtrëngoi dorën në shtëpinë e tij në Mitrovicë. Ishte besimplotë dhe i palëkundur se Kosova do të bëhet. Ishte ai që me fjalët e tij na motivoi ne se duhet të mbledhim forcat dhe dhimbjen ta kthejmë në energji për të vazhduar punën e kryetarit Veseli në shtetndërtimin e Kosovës. Një baba shembull që i edukoi të gjithë fëmijët e tij me ndjenjën e përhershme të atdhedashurisë. I qoftë i lehtë dheu i Kosovës!", ka shkruar Hoxhaj.

Ali Ahmeti: Fazli Veseli edukoi fëmijët e tij me dashurinë për atdheun

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka ngushëlluar Kadri Veselin për vdekjen e babait. Ai ka thënë se baca Fazli ka qenë një burrë shembullor, duke edukuar djemtë e tij në frymën e atdhedashurisë. "I dashur Kadri, me pikëllim të thellë mësova lajmin për ndarjen nga jeta të baba Fazliut. Shpreh ngushëllimet më të sinqerta juve dhe familjes, për të mbledhur forcat e për të

përballuar këtë humbje në këto çaste mungese. Një burrë shembullor, që ka edukuar fëmijët e tij me dashurinë për atdheun, një motivim që gjithnjë kishte forcë dhe energji për t'i shtyrë përpara proceset të cilat i kishte nisur. Mungesa jote e bën këtë humbje edhe më të rëndë dhe shpresoj që të kthehesh sa më parë në Kosovë, pranë familjes dhe miqve. I qoftë i lehtë dheu i Kosovës!", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".





ËSHTË MBAJTUR DEBATI PARLAMENTAR PËR MARRËVESHJEN E UASHINGTONIT

Kurti kritikon marrëveshjen e Uashingtonit, opozita kërkon zbatimin e saj

Subjektet opozitare i kanë kërkuar kryeministrin Albin Kurti që ta zbatojë Marrëveshjen e Uashingtonit, ndërsa i pari i qeverisë ka kritikuar disa pika të kësaj marrëveshje. Kryeministri Kurti ka akuzuar ish-kryeministrin Hoti që e ka nënshkruar atë marrëveshje, duke thënë se ka bërë veprim antikushtetues kur është zotuar për moratoriumin njëvjeçar të aplikimit në organizatat ndërkombëtare

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 KORRIK - Pozita dhe opozita sërish janë përplasur në Kuvendin e Kosovës për Marrëveshjen e Uashingtonit, të cilën Kosova dhe Serbia e kanë nënshkruar në shtator të vitit të kaluar në Shtëpinë e Bardhë. Në debatin parlamentar për zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit, të thirrur nga LDK-ja, opozita i ka bërë thirrje kryeministri që ta zbatojë këtë marrëveshje. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka thënë se pikat e kësaj marrëveshjeje janë kundër kushtetuese.

Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka kërkuar që deputetët të miratojnë një rezolutë e cila do

ta ndihmonte qeverinë që ta zbatojë Marrëveshjen e Uashingtonit. “Këtë marrëveshje duhet parë si një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Marrëveshjet e tilla, siç na tregon historia, por edhe përvoja jonë në ndërtimin e shtetit, krijojnë realitete të reja gjeopolitike. Në ato realitete të reja vendimmarrja për synimet e tona në konsolidimin e shtetit të Kosovës bëhet e natyrshme dhe gjen mbështetje nga bota perëndimore. Ata që nuk e kuptojnë këtë filozofi të veprimit politik nuk e kuptojnë edhe qëllimin e kësaj marrëveshjeje”, ka deklaruar Hoti, i cili e kishte nënshkruar këtë marrëveshje.

Ai ka përmendur efektet e kësaj marrëveshjeje duke thënë se ajo ia ka thyer izolimin e Kosovës. “Me këtë marrëveshje, edhe përmes një qeverisjeje parimore dhe konsultative si brenda ashtu edhe me miqtë ndërkombëtarë, ne kemi thyer izolimin ndërkombëtar që i kishte ndodhur Kosovës”, ka deklaruar ai.

Hoti ka treguar se edhe ish-presidenti amerikan këtë dokument e ka vlerësuar si një marrëveshje ekonomike që do të shtynte dy vendet më lehtë drejt marrëveshjes finale. “Prandaj, mbi këtë qasje është arritur marrëveshje në Shtëpinë e Bardhë. Përtej kësaj, këtë marrëveshje duhet parë edhe si një hap i rëndësishëm drejt konsolidimit të shtetit të

Kosovës në arenën ndërkombëtare”, ka deklaruar ai, duke shtuar se ata që nuk e kuptojnë këtë filozofi të veprimit politik, nuk e kuptojnë edhe qëllimin e kësaj marrëveshjeje. “Marrëveshja e Uashingtonit ka krijuar një momentum të ri edhe në marrëdhëniet BE-ShBA, duke qenë se tash ShBA-ja merr një rol të rëndësishëm politik dhe ekonomik në regjion. Prandaj, këtë marrëveshje duhet parë si hap drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve dhe njohjes reciproke”, ka deklaruar Hoti. Por, ndryshe mendon kryeministri Albin Kurti. Sipas tij, kjo marrëveshje është antikushtetuese. “Marrëveshja e Uashingtonit thuhet se na e paska thyer izolimin ndërkombëtar, a vetë në atë tekst kërkohet në pikën e parafundit se do të kemi moratorium njëvjeçar për mosanëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Në fakt, është nënshkrim i një qëndrimi antikushtetues. Unë nuk besoj

që duhet të kemi liderë institucionalë që do të lavdërohen me shkelje të Kushtetutës me paramendim”, ka thënë Kurti.

Ai ka mohuar kritikën e opozitës se është kundër amerikanëve. Para deputetëve ai ka ftuar opozitën që të mos e mbrojnë ShBA-në prej tij. “Ne jemi partnerë seriozë të ShBA-së. Prandaj thirrjet që po bëni për seriozitet në raportet me ShBA-në ne i marrim shumë seriozisht. Mos harroni që me këso mbrojtje që ju pretendoni t’ia bëni ShBA-së prej meje, jeni qesharakë. Duhet ta pushoni këtë lloj mbrojtje të ShBA-së prej meje. Me çka duhet të merrem unë, por është e vërtetë që nganjëherë duhet të merrem edhe me të kaluarën”, është shprehur Kurti.

Më tej, Kurti ka thënë se ishte ish-kryeministri Hoti i cili ia ka mundësuar presidentit serb të hyjë në Shtëpinë e Bardhë. “Do të ishte e pamundur për Serbinë që kreun e saj shtetëror, pjesëmarrësin e luftërave në ish-Jugosllavi, ministrin e

Informatave të Millosheviqit, ta mirëpresë pa ia shtruar paraprakisht qilimin e kuq pikërisht dikush nga vendi i viktimave dhe askush më pak se kryeministri i atëhershëm. Pra, ky ishte efekti i menjëhershëm i atij nënshkrimi para se të ndodhë”, ka deklaruar Kurti. Sa i përket studimit të fizibilitetit për Liqenin e Ujmanit, të cilin e kanë bërë amerikanët, ai ka thënë se do të studiohet. “Liqeni i Ujmanit është liqen artificial, liqen nga Kosova, i Kosovës. Ne do t'i përdorim të gjitha argumentet në këtë studim të fizibilitetit të publikuar së fundmi, por jo vetëm. Edhe studimet e tjera për ta mbrojtur këtë pasuri të Kosovës nga çfarëdo pretendimi. Pra, qëndrimi ynë është i qartë, sa më shumë argumente që të gjejmë aq më mirë do të jetë dhe sa më pak sulme që do të ketë për këtë

pasuri të Kosovës, sigurisht që aq më mirë do të jetë”, ka deklaruar Kurti. Kurti është kritikuar edhe nga subjektet e tjera opozitare. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, e ka quajtur të papërgjegjshëm Kurtin. “Ky njeri, ky kryeministër, po tregohet shumë i papërgjegjshëm për secilën fushë, edhe për politikën e jashtme për të cilën sot jemi duke diskutuar. Nuk e dimë si ka me vepruar me Ujmanin dhe me pikat e tjera. Ke marrë votë që ta drejtosh vendin mbi këto argumente e, në anën tjetër, e keni vendosur njëfarë diskursi shumë interesant”, ka deklaruar Tahiri. Ai ka kërkuar që qeveria të tregojë qëndrimin e saj për secilën pikë të Marrëveshjes së Uashingtonit. Edhe kryetari i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik



Tahiri, ka pasur disa kërkesa për kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Ai ka kërkuar që në raport me marrëdhëniet bilaterale me ShBA-në, të jenë më seriozë dhe mos të lënë paqartësi me këto raporte. “Presim të kërkonim edhe nga presidenti Biden të marrë leadership dhe kërkojmë nga ju të keni kërkesë të qartë në raport me emërimin e një emisari special të ShBA-së në dialogun

Kosovë-Serbi”, ka deklaruar Tahiri. Sipas tij, aty ku ka munguar prania e administratës amerikane, aty nuk ka pasur sukses në dialog. “Ruaj marrëdhëniet sepse janë të ndërtuara me dekada dhe është kërkesa jonë që ju të jeni serioz dhe mos të keni paqartësi. Paqartësia në raport me ShBA-në është lojë me zjarr!”, ka deklaruar ai.

Kosova dhe Serbia më 4 shtator të vitit 2020 kanë nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë në Uashington dy dokumente për normalizimin e raporteve ekonomike në prani të ish-presidentit amerikan Donald Trump. Marrëveshja ishte nënshkruar në mes të ish-kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vučić.

Kuvendi i Kosovës miraton rezolutë për gjenocidin në Srebrenicë

PRISHTINË, 7 KORRIK (ER) - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar rezolutën për dënimin e gjenocidit në Srebrenicë - Bosnje e Hercegovinë. Rezoluta është iniciuar nga koalicioni boshnjak në Kuvendin e Kosovës. Deputetët e Listës Serbe kanë lëshuar sallën para kësaj pike të seancës. Në bazë të rezolutës, dënohet ashpër gjenocidi i shtetit serb në Srebrenicë ndaj pjesëtarëve të popullit boshnjak dhe të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe dënohet çdo tendencë për ta mohuar qëllimisht dhe publikisht gjenocidin e Srebrenicës, me qëllim të denigrimit të viktimave dhe fshehjen e motiveve të krimeve të kryera. Rezoluta, po ashtu, fton institucionet shtetërore që të nderojnë viktimat e gjenocidit në Srebrenicë dhe, duke marrë parasysh se Parlamenti Evropian e ka shpallur këtë Ditë të Përkujtimit për gjenocidin në Srebrenicë, data 11 korrik të shpallet ditë përkujtimi për gjenocidin në Srebrenicë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se miratimi i rezolutës për Srebrenicë është “veprim fisnik dhe i duhur”. Ai ka deklaruar se kjo ishte masakra më e madhe në Evropë që prej përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe, sipas tij, duhet të bëhet dënimi i krimeve të tilla gjenocidiale, me qëllim që veprime të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. Sipas Kurtit, padia për gjenocid ndaj Serbisë, që po përgatit Kosova, do të kontribuojë që në të ardhmen të mos përsëriten ngjarje siç ndodhën në Srebrenicë. “Ata që nuk e pranojnë fajin e nuk kërkojnë falje, thellë në zemër besojnë se kanë pasur të drejtë”, ka thënë Kurti. Ndërsa Bahrim Shabani nga koalicioni Vakrat, teksa ka paraqitur rezolutën, ka thënë se ajo ka për

qëllim drejtësinë për viktimat. “Qëllimi për të miratuar këtë rezolutë është të mos harrojmë ose mohojmë gjenocidin në Srebrenicë kundër boshnjakëve dhe t'u japim viktimave të gjenocidit sa më shumë drejtësi të merituar, në mënyrë që ta kthejmë rajonin drejt një të ardhme më të ndritur për të inkurajuar pajtimin e popujve në Ballkanin Perëndimor”, ka thënë Shabani. Në anën tjetër, nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Saranda Bogujevci, ka thënë se populli i Kosovës ka pasur përjetim të ngjashëm me popullin boshnjak. “Vuajtjet e popullit boshnjak i njohim më së miri ne, populli shqiptar që përjetoj krimet barbare të regjimit të Serbisë ngjashëm gjatë luftës në Kosovë. E kemi përjetuar në lëkurën tonë”, ka thënë Bogujevci. Më tutje, shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se drejtësia për gjenocidin në Srebrenicë është vonuar. “Nuk mund të mos e përmendim drejtësinë e vonuar ndërkombehtarë që kemi pasur për 26 vjet edhe për këtë krim e gjenocid, por edhe ndaj atyre njerëzve që pas Srebrenicës, pothuajse një pjesë e madhe kanë bërë krime edhe në Kosovë”, ka thënë Tahiri. Kurse deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Driton Selmanaj, ka ftuar edhe shtetet e tjera që ta dënojnë gjenocidin në Srebrenicë. “Ne jemi të bindur që edhe më tutje shtetet demokratike do ta dënojnë fuqishëm aktin gjenocidial që ka ndodhur në Srebrenicë”, ka thënë ai. Edhe shefi i grupit parlamentar i



Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se, përveç gjenocidit të kryer në Srebrenicë, nuk duhet të harrohen as krimet e kryera në Kosovë. “Në asnjë moment dhe asnjë rrethanë nuk duhet të harrojmë dhe të ndalemi së foluri për agresorin dhe regjimin e (Sllobodan) Millosheviqit dhe krimet që ka kryer në këtë vend”, ka thënë Tahiri. Edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka mirëpritur miratimin e rezolutës nga Kuvendi për gjenocidin në Srebrenicë. “Me këtë rezolutë Kuvendi e zyrtarizoi qëndrimin e institucioneve dhe të popullit të Kosovës karshi gjenocidit serb ndaj qytetarëve boshnjakë të Srebrenicës. Për më tepër, nëpërmjet kësaj rezolute dënohet mohimi i qëllimshëm e publik i krimet të gjenocidit. Tmërrë që ka

përjetuar një popull i tërë në Bosnje dhe Hercegovinë, e më pas edhe në Kosovë, të dyja viktimat të regjimit gjenocidial serb, duhet t'i thërrasë ndërgjegjes njerëzore që synime të tilla shfarosëse të mos lejohen më në të ardhmen e, mbi të gjitha, që të ketë drejtësi për krimet e regjimit të Millosheviqit”, ka thënë Osmani. Ndaj kësaj rezolute ka reaguar presidenti i Serbisë, Aleksandër Vučić, duke thënë se një gjë e tillë ka qenë e pritshme nga Kuvendi i Kosovës. “Rezoluta të tilla do të vazhdojnë. Ne mund t'i shmangim ato në disa parlamente falë marrëdhënieve miqësore, por disa do të vazhdojnë me abuzimin politik të serbëve”, ka thënë Vučić gjatë një vizite në një spital të Beogradit. Kuvendi i Kosovës e ka miratuar rezolutën para se të shënohet

përvjetori i 26-të i gjenocidit në Srebrenicë. Përkatësisht, të dielën, më 11 korrik, parashihet edhe varrosja e 19 viktimave të gjenocidit. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ka konstatuar në vitin 2007 se vrasjet në Srebrenicë kanë përbërë gjenocid. Më 8 qershor 2021 gjykatësit e Kombeve të Bashkuara e kanë mbështetur dënimin me burgim të përjetshëm ndaj ish-shefit ushtarak serb, Ratko Mlladiq, për gjenocidin në Srebrenicë dhe mizoritë e tjera gjatë gjithë luftës së Bosnjës më 1992-95. Mekanizmi Ndërkombëtar për Gjykatat Penale ka konfirmuar dënimin me burgim të përjetshëm, i shpallur nga shkalla e parë më 2017, për rolin e tij në vrasjen e rreth 8 mijë burrave dhe djemve myslimanë boshnjakë në Srebrenicë.

Një i vdekur dhe nëntë raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 7 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë ka ndërruar jetë një person nga Covidi dhe janë paraqitur nëntë raste të reja me koronavirus. Po


ashtu, MSh-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë vaksinuar 5 251 qytetarë. “Në 24 orët e fundit janë dhënë 5 251 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha

qytetet e Kosovës janë dhënë 236 035 doza të vaksinës. Deri më sot 57 994 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 1 575 testime, 9 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24

orëve të fundit është shënuar 1 rast i vdekjes. Sot janë shënuar 8 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 105 405. Në total numri i rasteve aktive është 152”, ka njoftuar MSh-ja.



Osmani: Pjesëmarrja e grave në politikë, shtyllë kryesore e demokracisë



PRISHTINË, 7 KORRIK (ER) - Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) ka lansuar raportin mbi vlerësimin gjinor “Deficiti demokratik në Kosovë: Pjesëmarrja e plotë e grave”. Me këtë rast, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se pjesëmarrja e grave në politikë është shtylla kryesore për një demokraci. Ajo ka thënë se fokusi duhet të jetë në shkollimin e grave, në mënyrë që të fuqizohet zëri i tyre. “Vetëm duke kuptuar gjendjen aktuale të grave ne mund të kemi një rrugë të drejtë për të arritur progres më të madh në këtë fushë. Pjesëmarrja e grave në politikë është shtylla kryesore për një demokraci. Është me rëndësi të diskutojmë si të ecim përpara. Ndryshimi po ndodh sepse

qytetarët e kanë të qartë sepse ka rezultate edhe në ekonomi. Ishin gratë që votuan për gratë. Pjesëmarrja e grave vazhdon me paragjykimet e shumta. Fokusi ynë duhet të jetë në shkollim dhe edukim. Fuqizimi i zërit të tyre përmes platformave të ndryshme dhe gjithëpërfshirja në vendimarrje janë parakushte për politika të barabarta”, ka thënë Osmani, duke shtuar se mund të flasim për demokraci vetëm atëherë kur ka barazi të garantuar. “Duke e kuptuar rëndësinë për përfaqësim të barabartë është e nevojshme të shohim çështjet ekonomike. Ne kemi fatin të kemi gra dhe vajza jashtëzakonisht të përgatitura. Shumica e problemeve që përballen qytetarët kanë të bëjë me

punësim. Për atë na duhen njerëz më të ndjeshëm”, është shprehur Osmani. Ndërsa Nancy Soderberg, drejtoreshë e NDI-së në Kosovë, ka thënë se pengesat më të mëdha për gratë mbeten partitë politike. “Suksesi i demokracisë së Kosovës varet nga pjesëmarrja e plotë e grave. Ky vlerësim nuk do të ishte i mundur pa partitë politike. Ky vlerësim i vitit 2021 vlerëson se ku ka arritur fusha e progresit. Tanimë kemi presidente grua për të dytën herë. Hulumtimet e NDI-së thonë se gratë janë më inteligjente se burrat. Ende shumë ka për t’u bërë dhe Kosova ka nevojë për më shumë pjesëmarrje të grave. Pengesat më të mëdha për gratë ngelen në të gjitha partitë politike.

Këto gjetje ofrojnë hartë për t’u mundësuar grave të jenë në pozitat udhëheqëse. NDI-ja po lanson iniciativë që re në Kosovë për pjesëmarrje të grave. Demokracia në çdo vend është e vështirë, por pa gratë është e pamundur”, ka thënë ajo. Në anën tjetër, Christine Danton, drejtoreshë e Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje në USAID, ka thënë se kur gratë janë të përfshira në procese vendimmarrëse, paqja është e garantuar. “Është nder i madh për të lansuar raportin për vitin 2021. Kosova për herë të dytë po e zgjedh një presidente grua. Pjesëmarrja e grave ende nuk është arritur në nivelin lokal. Ky raport tregon punën që ka mbetur për t’u bërë dhe ka të bëjë me

parandalimin e dhunës ndaj grave. Gjatë cikleve zgjedhore gratë kufizohen për t’u marrë për çështje të grave. Kur gratë janë të përfshira, kemi paqe. Lansimi i vlerësimi është në kohën e duhur për të ecur tutje për zgjedhjet në tetor dhe është mundësi e mirë të kemi gra në procese vendimmarrëse. Kosova ka nevojë për një të ardhme prosperuese”, ka thënë ajo. Më tutje, Christine Todd Whitman, guvernatore e New-Jerseyt në ShBA, ka thënë se në çdo studim që është bërë ka rezultuar se kudo që marrin pjesë gratë, shoqëria është më e mirë. Kurse Pranvera Lipovica, drejtoreshë e programit në NDI, ka thënë se zgjedhjet e fundit në Kosovë kanë rritur pjesëmarrjen e grave në proceset vendimmarrëse.

Kurti takon shefin e OSBE-së, bisedojnë për zgjedhjet lokale

Prishtinë, 7 korrik (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka takuar të mërkurën në takim shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin Michael Davenport. Zyra e kryeministrit ka njoftuar se në

këtë takim është biseduar për zgjedhjet lokale të cilat do të mbahen më 17 tetor. “Gjatë takimit, po ashtu, u bisedua edhe për çështjen e përmirësimit të përkthimit në gjuhët zyrtare në mënyrë që qasja në informata, njoftime

dhe të dhëna me interes publik të lehtësohet, po ashtu edhe për qendrat mësimore të komuniteteve joshumicë dhe për mundësitë e financimit të qëndrueshëm të tyre”, ka njoftuar zyra e kryeministrit.



GJENERALI I PENSIONUAR AMERIKAN, WESLEY CLARK, KA VIZITUAR KOSOVËN

Wesley Clark: Kosova ka bërë përparim mbresëlënës drejt demokracisë

Ish-komandanti Suprem i Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, gjenerali amerikan Wesley Clark, është shprehur i impresionuar me të arriturat e Kosovës. Gjenerali i pensionuar amerikan, i cili është pritur me nderime të larta ushtarake, ka deklaruar se Kosova ka bërë përparime mbresëlënëse drejt demokracisë dhe lirisë

“Epoka e re”

PRISHTINË, 7 KORRIK - Gjenerali i pensionuar amerikan Wesley Clark është pritur të mërkurën në Kosovë me ceremoni shtetërore në Ministrinë e Mbrojtjes të Kosovës. Clarku, i cili është komandant Suprem i Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, në kohën e ndërhyrjes në Republikën Federale të Jugosllavisë, në vitin 1999, me qëllim të ndaljes së dhunës në Kosovë, është shprehur i impresionuar me të arriturat në Kosovë. Pas takimit me ministrin e Mbrojtjes, ai ka thënë se Kosova ka bërë përparim mbresëlënës drejt demokracisë dhe lirisë. “Jam i nderuar të jem këtu, jam i lumtur të

rikthehem në Kosovë. Kjo është mundësia e parë që kam pasur për ta vizituar këtë ministri. Jam i impresionuar. Gjatë viteve kam parë përparimin e Kosovës. Është një marsh mbresëlënës drejt demokracisë dhe lirisë. Shpresoj edhe për rritjen e prosperitetit ekonomik për popullin e Kosovës”, ka deklaruar Clark në një konferencë për media.

Ai ka deklaruar se populli i Kosovës i ka dhënë një shembull botës për vendosmëri. “Populli i Kosovës i dërgon një shembull të fortë botës se çfarë është vendosmëria që të jetojnë dhe t’i shërbejnë demokracisë dhe çfarë do të thotë të japësh për vendin tënd”, ka deklaruar Clark.

Gjenerali Clark ka deklaruar se



ndihet i lumtur që viziton Kosovën përsëri. “Jam shumë i lumtur që jam në Kosovë. Pres të takoj zyrtarët e qeverisë dhe ta uroj kryeministrin dhe ministrat për detyrën. Faleminderit për mikpritjen e ngrohtë!”, ka deklaruar ai.

Në anën tjetër, ministri Mehaj e ka njoftuar ish-komandantin Clark për kapacitetet e FSK-së. “Sot kemi nderin të mirëpresim gjeneralin historik të ShBA-së. Ai ka rol kyç për lirinë e Kosovës. E informova gjeneralin për të arriturat e FSK-së, e njoftova për punën e ministrisë së Mbrojtjes. Kisha nderin të ndaj me gjeneralin përkushtimin e ministrisë për ngritjen e kapaciteteve për FSK-në dhe ngritjen e buxhetit”, është shprehur Mehaj.

Ai ka deklaruar se Kosova tashmë me trupat e saj po jep kontribut në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në botë. “FSK-ja ka primar integrimin në NATO dhe mbrojtjen e sigurisë dhe paqes në botë. Siç e dini, ne i kemi djemtë tanë në Kuvajt. Kjo

është një arritje e madhe që e ka bërë Kosova bashkë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kosova nuk do të jetë më si përpara, të importojë siguri, por do të eksportojmë siguri edhe më tutje për të ardhmen”, ka thënë Mehaj.

Më pas gjenerali Clark është takuar edhe me ministrin e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, kryeministrin Albin Kurti, presidenten Vjosa Osmani dhe kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca.

Qendra për Studime Universitare e FSK-së merr emrin “Wesley Clark”

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka emëruar shkollën e oficerëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës si Qendra e Studimeve Universitare “Wesley Clark”. Ai ka treguar se ky nderim është në shenjë të mirënjohjes dhe falënderimit të përjetshëm për atë që ka bërë për Kosovën. “Kisha nderin t’i ndaj me

gjeneralin planet e Qeverisë së Kosovës për ministrinë dhe FSK-në. Sot për nder të gjeneralit do të emëroj shkollën tonë të oficerëve, qendrën e studimeve me emrin Wesley Clark. Kjo është më e pakta që mund të bëjmë për nder të tij”, ka thënë Mehaj pas takimit me gjeneralin amerikan.



PDK-ja e dërgon në Kushtetuese vendimin për shkarkimin e anëtarëve të KPMSHCK-së

PRISHTINË, 7 KORRIK (ER) - Deputetët e grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kanë dorëzuar të mërkurën në Gjykatën Kushtetuese kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit përmes të cilit theksojnë se anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) janë shkarkuar në mënyrë kundërkushtetuese dhe arbitrare. Në këtë kërkesë, PDK-ja ka argumentuar se Kuvendi në mënyrë kundërkushtetuese ka shkelur dy nene konkrete të Kushtetutës, respektivisht nenin 101 (shërbimi civil) dhe 142 (agjencitë e pavarura) të Kushtetutës. “Ky këshill është institucion i pavarur i nivelit

kushtetues dhe garanton standardet e meritës, profesionalizmit, neutralitetit ndaj politikës dhe të karakterit të shërbimit civil në kuadër të administratës së shtetit. Po ashtu, në bazë të përgjegjësisë kushtetuese të këtij institucioni të pavarur, qeveria, Kuvendi dhe organet e tjera politike zhvishen nga kompetencat e ndërhyrjes në shërbimin e pavarur civil të Kosovës, sepse Kushtetuta, një kompetencë të tillë, ia ka dhënë vetëm këtij Këshilli si institucion i pavarur nga ndikimet politike”, është thënë në lëndën e PDK-së të dërguar në Gjykatën Kushtetuese.

Për më tepër, sipas PDK-së, anëtarët e KPMSHCK-së janë shkarkuar në mënyrë kolektive,



përkundër faktit të pakontestueshëm që anëtarët e këtij institucioni zgjedhen individualisht në një procedurë të përcaktuar qartësisht në Kuvend. “Kjo përbën shkelje edhe të procedurës e cila është ndjekur për shkarkimin e tyre. Po ashtu,

vendimi për shkarkimin (ndërprerjen) e mandatit të anëtarëve të Këshillit është kundërkushtetues sepse me rastin e shkarkimit nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet e parapara në nenin 15 (ndërprerja e mandatit të anëtarit të këshillit)

të Ligjit nr. 06/L- 048, aq më tepër që dispozitat e këtij ligji i janë nënshtruar kontrollit në Gjykatën Kushtetuese (shih aktgjykimin në rastin KO171/18) ku, përveç të tjerash, neni 11, paragrafi 3, relevant për rrethanat e rastit konkret, që u garanton imunitet funksional kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit, u vlerësua në tërësi në pajtim me Kushtetutën”, është thënë në shkresën e PDK-së dërguar në Kushtetuese ku, po ashtu, theksohet se Kuvendi me vendimin e tij ka vepruar në kundërshtim me garantitë e dhëna me ligj me këtë aktgjykim. PDK-ja ka paralajmëruar qysh në fillim të kësaj legjislatore se do ta monitorojë dhe denoncojë çdo shkelje të pushtetit aktual.

Pritet rritje e theksuar e çmimeve të derivateve të naftës në Kosovë

PRISHTINË, 7 KORRIK - Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, ka bërë me dije se në ditët në vijim pritet të ketë rritje të theksuar të çmimeve të derivateve të naftës në Kosovë. Në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo rritje është e imponuar nga tregjet

ndërkombëtare, për të cilën gjë, sipas tij Kosova, nuk mund t'i bëjë ballë rritjes së çmimeve. "Momentalisht çmimi i naftës për dizel sillet nga 1.10 euro, ndërsa për benzinë deri në 1.20. Sa i përket rritjes së çmimeve dihet që kjo është e përcaktuar nga berëza ndërkombëtare dhe

Organizata Prodhuese e Naftës (OPEC). Ka reduktim të prodhimit në nivel global dhe si rrjedhojë kemi rritje të çmimit në mënyrë automatike. Prandaj, në ditët në vijim pritet që çmimet e derivateve të kenë rritje të theksuar", ka deklaruar Berjani.

Kujtojmë se të martën është raportuar në mediat globale se nafta bruto amerikane (WTI) është rritur në nivelin më të lartë në gjashtë vjetët e fundit, pasi vendet e prodhimit të saj dështuan të arrijnë një marrëveshje mbi kuotat e prodhimit pas muajit gusht. (A. MAVRAJ)



320 punëtorëve të Telekomit u ndërrohen pozitat, sindikata paralajmëron padi

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 KORRIK - Të mërkurën një numër i konsiderueshëm i punëtorëve të Telekomit të Kosovës kanë vërejtur se u janë ndryshuar pozitat dhe pagat. Ata nuk kanë pranuar njoftime ose vendime lidhur me këto çështje, ndërsa vazhdojnë të jenë të shqetësuar me fatin e tyre. Deri më tani bëhet fjalë për 320 persona që kanë qenë "viktima" të këtyre ndryshimeve të paparalajmëruara.

Bordi i përkohshëm i Telekomit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur ditë më parë ka marrë vendim që të gjitha vendimet për caktimin në pozita të ndryshme në këtë ndërmarrje dhe vendimet e sistemimit dhe gradimit që janë lëshuar që nga viti 2018 deri më 2019 të shfuqizohen. I menjëhershëm ka

qenë shfuqizimi i këtij vendimi nga ushtruesja e detyrës e kryshefes së Telekomit, Burbuqe Hana, e cila pa vendim të bordit ka ndërprerë edhe kontratat, duke i selektuar vitet 2018 dhe 2019, si dhe ka bërë degradimin, duke i kthyer në pozita të mëparshme. Ndërsa sipas informatave brenda Telekomit të Kosovës, Hana pritet të emërojë në pozita udhëheqëse punëtorë pa përvojë drejtuese. "Edhe pse kohë më parë vetë Burbuqe Hana ka qenë e degraduar nga menaxhmenti i kaluar dhe që më anë të gjykatës e ka fituar gjyqin dhe i ka marrë të gjitha pagat sipas kontratës, ajo tani dëshiron që në vend se ta shpëtojë Telekomin nga kriza financiare, t'ua hapë rrugën punëtorëve ta padisin Telekomin në gjykata dhe t'i fitojnë të gjitha gjyqet", ka thënë një burim brenda Telekomit të Kosovës.



Gazeta "Epoka e re" ka kontaktuar edhe kryetarin e Sindikatës Profesionale të Punëtorëve, Muhamet Xhemajli, në lidhje me zhvillimet në Telekom. Ai ka thënë se të mërkurën është njoftuar për këto zhvillime. Në këtë kontekst, ai ka thënë se i janë drejtuar me një

shkresë Departamentit të Burimeve Njerëzore brenda Telekomit për të kuptuar se çfarë ka ndodhur me të vërtetë. Xhemajli ka konfirmuar se bordi i përkohshëm i kësaj ndërmarrje ka marrë vendim që në bazë të gjetjeve të auditorit t'i shfuqizojë të gjitha vendimet për emërimin

e punëtorëve gjatë vitit 2018 dhe 2019 në lidhje me pozitat, gradat dhe pagat. "Sipas informatave që kemi marrë nga punëtorët e tjerë, pa vendim të bordit janë anuluar edhe kontratat për pozita udhëheqëse kinse nuk janë respektuar rregullat e konkursit", ka thënë ai. Po ashtu, Xhemajli ka paralajmëruar se do t'i shikojmë vendimet e bordit dhe në bazë të gjetjeve qoftë kolektive apo individuale që janë bërë, do të ngrehin padi penale dhe kolektive në gjykatë ndaj këtyre vendimeve arbitrare.

Të gjithë ata që u janë ndryshuar pozitat dhe gradat kanë shprehur gatishmëri t'i drejtohen Inspektoratit të Punës dhe gjykatave për të kërkuar të drejtat e tyre. Kujtojmë se në javët e fundit ka pasur jo pak ndryshime në Telekom, ku pika kyçe ishte dorëheqja e drejtoreshës së marketingut, Vesa Haradinaj.

Peci mori pjesë në përrurimin e qendrës për përpunimin e ushqimit dhe aftësimin profesional nga IADK-ja



PRISHTINË, 7 KORRIK - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka marrë pjesë të mërkurën në përrurimin e Qendrës për Përpunimin e Ushqimit dhe Programit për Aftësim Profesional në ambientet e organizatës joqeveritare Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK). Me këtë rast, Peci e ka vlerësuar tejet të rëndësishëm trekëndëshin e bashkëpunimit në mes të nivelit qendror, atij lokal

dhe shoqërisë civile, me qëllim të zhvillimit të sektorit të bujqësisë, si dhe krijimit të politikave të qëndrueshme zhvillimore.

Po gjatë kësaj ceremonie ministri Peci ka theksuar rëndësinë e aftësimin profesional, ngritjen e kapaciteteve, si dhe avancimit të agjendës legislative e cila do t'i kontribuojë zvogëlimin të papunësisë, rritjes së eksportit, rritjes së prodhimit si dhe përmirësimit të cilësisë së prodhimeve vendore.

Në mes të tjerash, ministri Peci ka thënë se organizatat partnere si IADK-ja, të cilat përmes aftësimin profesional, dijes dhe kapaciteteve të tyre, janë shembull pozitiv i zhvillimit të sektorit të bujqësisë.

Qendra e Përpunimit të Ushqimit dhe e Programit për Aftësimin Profesional në Iniciativën për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës është investim i përbashkët i IADK-së dhe donatorëve të këtij sektori.

Posta e Kosovës: Jemi në shërbim të konsumatorëve

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Posta e Kosovës, me anë të një komunikate për media, ka theksuar se, pavarësisht prej vështirësive të shkaktuara nga pandemia, janë duke u kujdesur maksimalisht për t'u ofruar shërbime qytetarëve. "Të nderuar dhe shumë të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës, bordi i

përkohshëm i drejtorëve i Postës së Kosovës Sh.A., prej emërimit zyrtar në këtë ndërmarrje publike, po kryen me përkushtim detyrat dhe përgjegjësitë në bazë të ligjeve në fuqi. Në emër të aksionarit të Qeverisë së Kosovës, bordi i përkohshëm i drejtorëve si organ mbikëqyrës ka përcjellë në vazhdimësi nga afër punën

e menaxhmentit të Postës së Kosovës", është thënë në komunikatën e Postës së Kosovës, duke shtuar se fokusi kryesor i bordit të përkohshëm të drejtorëve dhe i menaxhmentit të Postës së Kosovës janë funksionaliteti dhe qëndrueshmëria e afarizmit të ndërmarrjes publike dhe ngritja e të hyrave

financiare. "Posta është e gatshme të marrë shërbimet postare nga institucionet qeveritare që i takojnë me ligj. Pavarësisht prej sfidave nga pandemia, Posta e Kosovës po u shërben qytetarëve dhe konsumatorëve të saj me përkushtim të lartë dhe kapacitet të plotë, çdo ditë në të gjitha zyrat postare në tërë



komunat e Republikës së Kosovës", është thënë në këtë komunikatë.

Haziri dhe Sinani: Pa zgjidhjen e problemit të Kosovës Lindore nuk ka paqe të qëndrueshme në rajon

GJILAN, 7 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim pune kryetaren e Komunës së Preshevës, Ardita Sinani, me të cilën janë marrë vesh për bashkëpunim të vazhdueshëm për zgjidhjen e problemeve ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të shqiptarëve, duke trajtuar të drejtën e shqiptarëve dhe parimin e vetëvendosjes që qytetarët e këtyre komunave ta kenë të drejtën e bashkimit me Republikën amë. “Sot ne së bashku me kryetaren e Preshevës kemi konfirmuar angazhimin maksimal për lehtësimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me qytetarët e Gjilanit, Preshevës dhe Kosovës Lindore në përgjithësi, që banorët e këtyre dy anëve të cilët janë në lidhje familjare, të gjakut dhe miqësore, të kenë liri të qarkullimit dhe pa pengesa. Zhvillimi ekonomik lokal është fokus i përbashkët gjithashtu që ekonomia dhe agrobiznesi të shënojnë hapa pozitivë në këtë drejtim duke aplikuar me projekte të përbashkëta në fonde dhe grante ndërkombëtare”, ka thënë Haziri pas takimit.

Ai ka thënë se janë fokusuar edhe për koordinimin e një kalendarit të përbashkët të aktiviteteve vjetore, respektivisht me çështjet që kanë të bëjnë me arsim, me kulturë dhe me aktivitete të tjera që janë interes i përbashkët. “Në kohën e zhvillimit të bisedimeve për normalizim të marrëdhënieve në



mes të Kosovës dhe Serbisë, çështja e shqiptarëve të Kosovës Lindore duhet të jetë pjesë e tavolinës dhe në interes të Qeverisë së Kosovës dhe të mandatuarit për negociatë. Parimi i reciprocitetit dhe parimi i të drejtës për vetëvendosje i qytetarëve të këtyre tri komunave nënkupton që t'u kthehet e drejta për të jetuar në Republikën amë të tyre, por ky është proces politik që

është në rifillimet e saj në këtë dekadë të re. Besimi im i madh është që njerëzit dhe besimi i tyre nuk mund të shkelet asnjëherë, i kalon përmasat e kërkesave të kohës dhe përmasat e ngushta të politikanëve, qofshin në Beograd apo në Prishtinë. Fundja, e drejta për të jetuar dinjitetshëm në shtëpinë e vet i takon secilit”, ka thënë Haziri.

Ndërsa Ardita Sinani, kryetare e

Komunës së Preshevës, pas takimit me kryetarin Haziri, ka falënderuar atë për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë gjithmonë për Kosovën Lindore dhe ka paraqitur shqetësime për problemet që kanë shqiptarët në tri komunat shqiptare të cilat janë sakrificë e rëndë e politikës në Beograd.

“Problemet e shqiptarëve në tri komunat shqiptare, Preshevë,

Bujanoc dhe Medvegjë, janë të shumta, që nga shkelja e të drejtave të njeriut, lirisë së lëvizjes e deri te mungesa e investimeve. Do të punojmë së bashku me kryetarin e Gjilanit që përmes projekteve të përbashkëta ndërkomunale e ndërkufitare të aplikojmë në fonde të Komisionit Evropian, në programe të IPA-s dhe te donatorë të ndryshëm për të investuar në projekte jetike dhe të domosdoshme për arsye se buxhet nuk kemi për të zhvilluar projekte në infrastrukturë publike, në bujqësi, ndërmarrësi të mesme dhe të vogël, shërbime komunale e deri te projektet kulturore”, ka thënë ajo.

Më tutje, Sinani ka thënë se pa zgjidhjen e problemit të Kosovës Lindore nuk ka paqe të qëndrueshme në rajon. “Problemet që kanë shqiptarët në tri komunat shqiptare Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë janë shumë të dhimbshme që nga ato sfidat e mëdha socio-ekonomike deri te mosekzistimi juridik i shqiptarëve përmes pasivizimit të adresave të vendlindjes. Diskriminimi është i vazhdueshëm. Serbia hap dialogun me Kosovën, ndërsa bllokun dialogun me këto komuna shqiptare atje dhe me përfaqësuesit shqiptarë. Mirëpo bisedimet, nëse nuk trajtojnë edhe zgjidhjen e shqiptarëve në Kosovën Lindore, nuk mund të garantojnë stabilitet dhe paqe të qëndrueshme në rajon”, ka thënë ajo.

GIZ-i gjerman sërish përzgjedh Drenasin për realizim projektesh

DRENAS, 7 KORRIK (ER) - Komuna e Drenasit është përzgjedhur një ndër komunat model për hartimin e doracakut për përmirësimin e proceseve të punës brenda drejtorive të urbanizmit në komunat e Kosovës.

Drejtoresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu, së bashku me drejtorin e Inspeksionit, Milaim Hajdari, dhe zyrtarë të komunës, kanë pritur në takim përfaqësuesit e GIZ-it gjerman dhe të kompanisë hartuese të cilët kanë bërë me dije se janë duke hartuar një doracak

për përmirësimin e proceseve të punës brenda drejtorive të urbanizmit në komunat e Kosovës, me qëllim të zbatimit të ligjit për planifikim hapësinor dhe ligjeve të tjera të ndërlidhura me sektorin e planifikimit.

Për ta vlerësuar gjendjen reale të këtyre është angazhuar një grup i konsulentëve vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët, në bashkëpunim me GIZ-in gjerman, kanë përzgjedhur tri komuna si model për të zhvilluar këtë doracak. Në këtë aspekt, komuna e Drenasit është parë si një nga rastet më të mira për të

zhvilluar një model të përmirësimit të proceseve brenda Drejtorisë së Urbanizmit, i cili pastaj do të mund të aplikohet në komuna të tjera.

Më tutje, drejtoresha Avdiu ka falënderuar GIZ-in gjerman që ka përzgjedhur komunën e Drenasit model për hartimin e këtij doracakut dhe ka theksuar se një bashkëpunim i tillë në mes të komunës së Drenasit, si përherë, konsulentëve të angazhuar dhe projektit të GIZ-it gjerman, do të sjellë rezultatet e pritura të cilat pastaj do të reflektojnë në këtë doracak.



Kamenica hap rrugët në disa zona malore

Kamenicë, 7 korrik (ER) - Komuna e Kamenicës ka njoftuar se është duke u angazhuar në hapjen e rrugëve në zonat më të thella

malore të kësaj komune. “Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim është duke u angazhuar për lehtësimin e qasjeve të rrugëve në zonat më të

thella malore. Zyrtarë nga kjo drejtori kësaj radhe kanë intervenuar në rrugën e Kitkës, përkatësisht në lagjen ‘Redenica’.

Drejtoria në fjalë është e gatshme për intervenime në çdo kohë kur është e nevojshme”, ka njoftuar Komuna e Kamenicës.



Kush e 'hangër' Dardaninë shqiptare?



Shkruan: Prof. dr. Mehdi HYSENI

Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Albin Kurti, bëri shumë mirë që pranoi në takim kryetarin e LSD-së së Vojvodinës, Nenad Čanak, i cili e njeh pavarësinë e Kosovës. Gjithashtu, do të kishte bërë mirë sikurse ai me presidenten Vjosa Osmani dhe me kryeparlamentarin Glauk Konjufca t'i përgjigjeshin kërkesës zyrtare të Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe të Arteve në Nju-Jork lidhur me ndryshimin e emrit sllav Kosovë në emrin burimor antik "Dardani". Megjithatë, mbesim me shpresë se do të na përgjigjen një ditë, edhe neve si institucion kombëtar shkencor, ashtu siç iu kemi drejtuar me një dërgesë postare (rekomandë), më 27 mars 2021. Besoj se kanë para kohë dhe mirëkuptim për dërgimin e një letre zyrtare me anë të postës. Pasi "Maqedonia" ndryshoi emrin në "Maqedoninë Veriore" (që në realitet asnjëra e as tjetra nuk kanë të bëjnë me Maqedoninë antike të Lekës së Madh), e ne çka po presim pse nuk po e ndryshojmë emrin

sllav "Kosovë" në toponimin burimor autokton iliro-shqiptar-Dardani?

Është turp i madh për ne, që deri më sot (XIII-XXI) asnjëherë nuk e kemi riaktualizuar këtë problem tejet serioz dhe ekzistencial për qenien shqiptare në Ballkan.

Për të rikujtuar dhe korrigjuar këtë padrejtësi të madhe historike jo më pak se 8 shekuj, Akademia Shqiptaro-Amerikane e Shkencave dhe e Arteve e Nju-Jorkut me kryetarin e saj Akademik Skënder Kodra në krye, më 27 mars 2021, u dërgoi me postë një kërkesë zyrtare presidentes, kryeministrit dhe kryekuvendarit të Kosovës, që ta marrin në shqyrtim memorandumun tonë, që ka të bëjë me ndryshimin e sintagmës emërtuese nga "Republika e Kosovës" në "Republika e Dardanisë". Mirëpo, fatkeqësisht, deri më sot (5 korrik 2021) nuk kemi marrë asnjë informacion zyrtar me shkrim as nga Vjosa Osmani (presidente), as nga Albin Kurti (kryeministër) e as nga Glauk Konjufca (kryekuvendar).

Arsyen e mospërgjigjes kërkesës sonë zyrtare, vetëm ata mund ta kenë ditur, askush tjetër.

Vetëm pas kthimit të Dardanisë, Beogradi do ta harrojë "Kosovën" e shpifur më 1216!

Prandaj, nuk duhet vonuar asnjë ditë zgjidhjen e kësaj çështjeje me peshë të madhe historike të identitetit të Dardanisë shqiptare. Ndryshe, popët, shteti, politika dhe

propaganda e Serbisë, vazhdimisht do të na akuzojnë para Evropës dhe para gjithë botës, se gjoja ua kemi shkëputur "Kosovën serbe" më 1999!?

Pra derisa të mos ia ndryshojmë emrin "Kosovë" në Dardani, do të kemi problem, konflikt dhe do të jemi në luftë me Serbinë kolonialiste gjenocidale (madje dhe brezat tanë të ardhshëm). Këtë duhet ta ketë parasysh, se me dialogun e Brukselit (2011-2021) nuk zgjidhet konflikti shumëshekullor i Dardanisë shqiptare (që për herën e fundit zhupanët dhe metohët serbomëdhenj invadues dhe kolonizues, e futën në dhe, duke e riemërtuar me emrin sllav "Kosovë e Metohi", që do të thotë tokë kishtarë, identitet serb dhe civilizim sllav!?

Prandaj, për të hedhur poshtë gënjeshtret dhe falsifikimet e tilla antishqiptare, shteti i Kosovës nevojitet të hidhet në veprim sa më parë të jetë e mundur, në mënyrë që ta rikthejë emërtimin e tij të vërtetë burimor - Dardani, e cila historikisht nuk njeh kurrfarë emërtimi sllav "Kosovë e Metohi", të ngulitur nga priftërinjtë serbomëdhenj me zhupanët e tyre mesjetarë, që më 1216 Dardaninë shqiptare e emëruan me emrin sllav "Kosovë e Metohi"!

Me kthimin e Dardanisë do të dëshmojmë identitetin tonë të lashtë të sferës dhe të qytetërimit

evropianoperëndimor.

Nëse pandehim se jemi ilirë dhe evropianë perëndimorë, ka ardhur çasti historik që ta vëmë në dijeni mbarë kombin shqiptar, Evropën dhe gjithë botën se në Dardaninë shqiptare nuk ka "Kosovë e Metohi", por vetëm një Dardani, emrin e së cilës e falsifikuan zhupanët dhe popët serbë, të cilët më 1216 e "kryqëzuan" me emrin "Kosovë e Metohi".

Pra, që atëherë e deri më sot (XIII-XXI) historiografia e rreme dhe falsifikatore serbomadhe sllave ballkanike, evropiane dhe botërore, shërbehet me toponimin sllav "Kosovë e Metohi", në vend të emërtimit të saktë antik "DARDANIA". Për më tepër, DARDANIA është kryeargumenti shkencor historik që përtrollis të gjitha gënjeshtret, mitet dhe falsifikimet e kuazishkencës dhe të Kishës Ortodokse (retrograde) Serbe, se gjoja "Kosova e Metohia janë djepi, zemra, koka serbe" etj. Kjo është rrena më e madhe në historinë e Ballkanit, të Evropës dhe të botës, mbase as në epokën romake e as në atë ilire nuk ka figuruar kurrfarë "Kosove" në Ballkan.

Nëse vërtet duam të lirohemi nga kanxhat shumëshekullore të kolonializmit gjenocidal serbomadhe, atëherë nuk kemi pse të vrapojmë kot pas "dialogëve" të Serbisë, sepse kjo nuk e njeh sovranitetin e Kosovës (17 shkurt 2008), duke qenë se e konsideron

"pronë të ligjshme" shtetërore dhe kishtarë, të cilën, siç deklaroi botërisht socialdemokrti dhe paqësori serb i LSV-së së Vojvodinës, Nenad Čanak, "Serbia me shtatë e ka fituar Kosovën më 1912", domethënë ushtarakisht me zjarr, me terror, me masakra dhe me gjenocid Serbia e ka aneksuar dhe pushtuar Kosovën shqiptare më 1912, përkatësisht Dardaninë shqiptare.

Për të mos u bërë robër të Serbisë kolonialiste dhe militariste, shteti i Kosovës, sa më parë do të duhej të nxirrte ligjin përkatës dhe të ndryshonte Kushtetutën (ashtu siç e ndryshoi për dialogun e Brukselit, 2011-2021, si dhe për Gjykatën Speciale të Hagës për dënimin e "krimeve" të UÇK-së) për ndryshimin e emrit sllav "Kosovë" në atë ilir-shqiptar "Dardani".

Nëse kjo procedurë ligjore dhe kushtetuese, nuk do të "ndizte", atëherë, pa vonesë, të shpallet referendum gjithëpopullor për rikthimin e emrit "Dardani", sepse ky është identiteti ynë i lashtë dhe i sotëm ilir-shqiptar, territorial, shtetëror, nacional dhe qytetëruar evropianoperëndimor.

Vetëm pasi ta kemi ringjallur emrin Dardani, atëherë do të mund të krenoheshim dhe të mburrehim se vërtet jemi faktor i rëndësishëm dhe i patejkalueshëm politik, kombëtar, civilizues, gjeopolitik dhe gjeostrategjik properëndimor.



DARDANIA ANTIKE

Mario Vargas Llosa: Shkrimtari, po ashtu si edhe pushteti, nuk është i detyruar të veprojë gjithmonë drejt

Keni përsëritur shpesh se letërsia e mirë nuk e mbështet kurrë të keqen, sidomos, ajo nuk duhet të bëhet palë me shtypësit dhe diktatorët. Mos do të thotë kjo se shkrimtari duhet të ketë parime morale të kulluara?

Të jem i ndershëm, unë nuk jam përkrahës i këtij pozicioni. Paralele të tilla mund të na shpien shumë larg. Përzierja e letërsisë me moralin është një çështje tepër e rrezikshme. Nëse fillojmë të gjykojmë nga pikëpamja e moralit, i bie ta ndajmë të gjithë letërsinë në të mirë dhe në të keqe. Por kjo është rrënjësisht e gabuar, sepse një vepër madhështore mund të mbështesë çfarëdo pozicionesh, ndërkohë që mund të jetë origjinale dhe e çmuar nga pikëpamja e kulturës.

Për shembull, Lui-Ferdinand Selin – një shkrimtar shumë i mirë francez – në pikëpamje të moralit, të flasim butë, nuk ka shkëlqyer: Ai ka qenë një makth i vërtetë: urrente hebrenjtë, mbështeste fashistët, ishte racist. Nga ana tjetër, Selini është një shkrimtar shumë original, që ka krijuar jo pak vepra të rëndësishme. Të paktën, dy nga romanet e tij mund t'i quash pa mëdyshje, të mëdhenj – këto janë "Vdekje me kredi" dhe natyrisht, "Udhëtim në fund të natës". Një shembull tjetër jo me më pak interes – ky është Knut Hamsun, një shkrimtar edhe më i shquar, për të cilin gjithashtu është shumë e vështirë të thuash diçka të mirë nga pikëpamja e preferencave të tij: të gjithë e dinë që ai simpatizonte Hitlerin. Prandaj e jani e të mos e ngatërrojmë pra letërsinë dhe moralin.

A duhet që shkrimtari bashkëkohor të jetë në opozitë me pushtetin, i cili merr vendime të dyshimta politike?

Kryesorja për mua është liria. Shkrimtari, po ashtu si edhe pushteti, nuk është i detyruar që kurdoherë të veprojë drejt. Secili ka të drejtë të gabojë, në fund të fundit. Por ai duhet të ketë mundësinë të shprehet lirish. Vetëm në këtë rast ato vlera, që ai përçon, do të perceptohen në mënyrë adekuate nga një shoqëri e lirë: dikush do ta mbështesë, dikush, natyrisht, do ta kritikojë. Por shkrimtari duhet të ketë domosdoshmërisht mundësinë për të shprehur mendimet e tij, ndjenjat dhe emocionet, pa i bërë qejfin asnjë instance të lartë. Më kryesorja, të mos ketë kurrfarë kufizimi.



Në vlerësimin e Kazuo Ishiguro, Komiteti i Nobelit theksoi me këtë rast, që ne jetojmë në një botë multikulturore, multigjuhësore. Edhe për ju është kjo përvojë: jeni lindur në Peru, keni jetuar në Spanjë, në Francë, në Britaninë e Madhe. Si ka ndikuar kjo përvojë në krijimtarinë tuaj?

Përvoja më e rëndësishme, që mund të ketë një shkrimtar, e gjitha merret në fëmijëri dhe rini. Pikërisht, me këtë lëndë të parë, me këtë bazament punon shkrimtari, duke e pasuruar me fantazinë e tij. Natyrisht, të gjitha vendet, ku kam qenë, të gjithë librat që kam lexuar dhe gjithë njerëzit që kam takuar, gjithashtu kanë ndikim në atë çfarë bëj. Por, përvoja ime më kryesore, përvoja që më ka formësuar – është rinia ime, që kam kaluar në Peru. Kjo ka ndikuar njëtrajtshëm në individualitetin tim, në atë se si e kuptoj letërsinë dhe në atë se si shkruaj.

Si ju duket, cili është roli i shkrimtarit në Amerikën Latine dhe në Europë? A ka dallime parimore në konceptim?

Roli i shkrimtarit kudo është i njëjtë – si në Rusi, si në Peru apo si në Kinë! Mjedisi shoqëror dhe veçoritë politike, natyrisht, sipas saj ndikon mbi këtë rol, por letërsia nuk mundet t'i përshtatet plotësisht atyre kushteve ku ajo krijohet. Shkrimtari i mirë gjithmonë u drejtohet çështjeve universale. Pikërisht për këtë veprat e shquara janë të kuptueshme për lexuesit pavarësisht prejardhjes dhe sfondit kulturor. Në Amerikën Latine ne mund të lexojmë lehtësisht Tolstoin, Dostojevskën, Çehovin, t'i kuptojmë dhe të marrim kënaqësi nga krijimtaria e tyre, sikundër nga ana e tyre, në Rusi e lexojnë dhe e

kuptojnë Borhesin, Markezën dhe Kortasarin. Letërsia është universale. Është pikërisht kjo që e dallon nga folklori dhe moda, e cila shpesh është e lidhur fort me traditën vendore. Letërsinë mund ta gjykojmë edhe nga pikëpamja rajonale, po ashtu. Nëse ajo nuk i shtron vetes pyetje universale, do të thotë që pushon së ekzistuari.

Në një intervistë keni thënë, që, pasi lexuat Foberin, vendosët të bëheshit ai shkrimtar që përshkruan ngjarje reale. Ndërkohë, shpesh ju lidhin me traditën e realizmit magjik. Si bashkëjetojnë te proza juaj këto dy tendenca?

Ideja e realizmit magjik nuk mund të thihet në vetvete gjithë atë pasuri të Amerikës Latine. Vetëkuptohet, ne kemi jo pak shkrimtarë, që përdorin trope fantastike në veprat e tyre, si tek Markez dhe Kortasar dhe Rulfo. Por ka edhe autorë të tjerë, që shumë më tepër tërhiqen nga realizmi. Unë jam njeri prej tyre. Realizmi kurdoherë më ka interesuar më shumë se fantazia. Ai imazh i botës, që vizatoj, është afër lexuesit, sepse nuk dallohet prej përvojës së tij personale. Përveç kësaj, realistët magjikë nuk i ngajnë njeri tjetrit: Borhes dallohet nga Kortasari, Markez nga Rulfo. Për më tepër kjo etiketa "realizmi magjik", nuk i ndihmon aspak lexuesit që të kuptojë poetikën e këtyre autorëve. Por, natyrisht, në Amerikën Latine fillesa fantastike ka një rëndësi të madhe për të gjithë autorët. Dhe kjo është logjike, sepse Amerika Latine është një vend që bashkon në vetvete një masë gjuhësh. Vetëm letërsia e mirë mund të formojë një qytetar të mirë që mendon lirish, i pavarur, me një fjalë, që vështirë se mund ta manipulojnë me ndihmën e propagandës.

Heronjtë tuaj shpesh shtegtojnë nga njeri roman në tjetrin. Si e merrni këtë vendim, cilës figurë i drejtoheni përsëri?

Oh, edhe vetë nuk e kam zgjidhur këtë gjë. Nuk mund ta them me siguri përse një hero kthehet dhe tjetri jo. Unë kam disa personazhe, të cilët periodikisht vijnë tek unë dhe futen vetë te romani i ri. Njeri prej tyre, për shembull Lituma, ai për herë të parë u shfaq në jetën time shumë kohë më parë, kur unë isha djalos dhe sapo kisha filluar veprat e mia të para. Në këtë rast shumica e personazheve të mi thjesht zhduken, duke u shfaqur vetëm një herë. Kurse Lituma mbetet. Mbase, problemi është se unë nuk e kam shfrytëzuar gjithë potencialin e mundshëm që gjendet tek ai, mbase, ai thjesht paraqet imazhin e tij universal, i cili mund të bëhet pjesë e veprave të mia të shumta. Ky është proces irracional, nuk mund ta shpjegoj në mënyrë logjike.

Në esenë "Civilizimi i spektaklit" ju përshkruani një botë ku zbatimja është bërë vlera kryesore e kulturës. A duhet që letërsia t'i bashkohet kësaj tendence?

Ky proces veçse është rënduar. Sot zbatimja është bërë i vetmi qëllim i artit vizual, ashtu edhe i letërsisë. Unë e kuptoj që autorët në këtë mënyrë përpiqen të arrijnë sa më shumë njerëz, por kjo sjell një thjeshtëzim të tmerrshëm të gjuhës, mendimit, formës së veprës. Ajo dëmton jo vetëm letërsinë, por edhe shoqërinë në tërësi. Tani ka jo pak mendimtarë, të cilët janë të bindur që kthim në zbatimje – është një rrugë shumë e mirë për shoqërinë e sotme. Për shembull, filozofi frëng Gilles Lipovetsky është i sigurt që më në fund kemi fituar një kulturë të

vërtetë demokratike, e cila është e kuptueshme për cilindo, kurse ajo elitare si fenomen i përket të kaluarës. Por unë nuk ndaj aspak këtë pikë pamje. Nëse letërsia është kthyer vetëm në zbatimje, atëherë ajo pashmangshmërisht do të degjenerojë, thjesht do të bëhet e painteres. Nëse bestsellerat do të zënë vendin e letërsisë cilësore, kjo do të jetë katastrofë për të gjithë kulturën.

E ndiqni pop-kulturën? A ka fenomene që ju interesojnë?

Natyrisht, më intereson kultura masive. Nëse dëshironi të zbatimeni, ajo u demonstroi një masë formatesh të larmishme, të lehtë dhe tërheqës për publikun. Pjesa më e madhe e filmave dhe serialeve është bërë shumë cilësore dhe e kuptueshme. Por unë nuk do ta përzieja kulturën masive me atë që quhet arti i lartë. Kjo s'është aspak e njëjta gjë. Leximi i njëfarë bestselleri popullor dhe leximi i Prustit apo Xhojsit kërkon përpjekje krejt të ndryshme.

Nëse letërsia është kthyer vetëm në zbatimje, atëherë ajo pashmangshmërisht do të degjenerojë, thjesht do të bëhet e painteres. Nëse bestsellerat do të zënë vendin e letërsisë cilësore, kjo do të jetë katastrofë për të gjithë kulturën.

Mund të kënaqeni me "Uliksin", apo, të themi, me veprat e Folknerit, vetëm nëse jeni i gatshëm të përmbledhni gjithë njohuritë dhe përfytyrimet tuaja. Vetëm kështu ju mund të kuptoni thellësinë dhe shumëfaqshmërinë e këtyre veprave. Po, seriale të tilla, si përshembull *Homeland* (atdheu), kjo është një zbatimje e mrekullueshme. Unë mundem të kënaqem gjithashtu prej tyre, por ka një dallim midis nivelit të ideve dhe cilësisë së realizimit, të cilat na i ve përpara arti i lartë dhe kultura e konsumit masiv.

Çfarë roli luajnë sot librat? A do t'ia dalin ato të ruajnë pozitën e tyre?

Ndikimi i librave të mirë është kolosal. Ata na japin mundësinë të ndjejmë se çfarë pasurie fsheh gjuha jonë amtare dhe ajo e huaj. Na ndihmojnë të shprehim mendimet tona shumë më saktë. Përveç kësaj, letërsia e madhe zhvillon ndjeshmërinë tonë. Ne fillojmë të kuptojmë më mirë se ç'ndodh në botën rreth nesh, fitojmë një qasje kritike ndaj realitetit. Vetëm letërsia e mirë mund të formojë një qytetar të mirë që mendon lirish, i pavarur, me një fjalë, që vështirë se mund ta manipulojnë me ndihmën e propagandës. /exlibris.al/

Përktheu: B. Hudhri

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Angli kualifikohet në finale të 'Euro 2020'

Në finalen e madhe të Evropianit "Euro 2020" do të përballen Italia dhe Anglia. Ndeshja finale zhvillohet në "Wembley" të Londrës më 11 korrik nga ora 21:00



"Epoka e re"

Londër, 7 korrik - Kombëtarja e Anglisë e ka shkruar historinë duke u kualifikuar për herë të parë në finale të një Kampionati Evropian. Këtë sukses skuadra përfaqësuese e Anglisë e arriti, pasi e mposhti Danimarkën në gjysmëfinale (2-1), pas vazhdimeve. Ishin danezët ata që shënuan të parët në ndeshje në minutën e 30-të, kur nga gjuajtja e lirë realizoi Mikkel Damsgaard. Ndërsa rezultati u barazua nëntë minuta me vonë me autogolin e Simon Kjaer. Në pjesën e dytë nuk pati gola të tjerë të shënuara dhe ndeshja shkoi në vazhdime dy herë nga pesëmbëdhjetë minuta. Në minutën e 104-të, Sterling u pengua në zonën e rreptësisë dhe gjyqtari kryesor akordoi penallti për Anglinë. Tentimin e parë të kapitenit Harry Kane e priti, Kasper Schmeichel, por nga topi i rikthyer shënoi sulmuesi

anglez për rezultati 2-1. Duhet cekur se Kane me golin e shënuar në gjysmëfinale e ka barazuar legjendën Gary Lineker për më së shumti gola në kampionate të tilla për "Tre Luanët", gjithsejtë 10 gola. Pas golit të epërsisë, Anglia ishte shumë e kujdesshme në fazën defensive duke mos lejuar danezët që të rrezikojnë seriozisht portën e Pickfordit. Rastin me të mirë për Danimarkën në pjesën e dytë shtesë e pati sulmuesi i Barcelonës, Martin

Braithwaite goditjen e të cilit e ndali portieri anglez. Kapiteni i Anglisë gjithashtu nga UEFA është shpallur lojtari i ndeshjes, Anglia - Danimarka, e cila u luajt në "Wembley" të Londrës. Pavarësisht eliminimit ky është një sukses i madh për Danimarkën. Në finalen që zhvillohet të dielën nga ora 21:00, Anglia do të përballlet me Italinë. Kjo e fundit e mposhti të martën Spanjën, pas ekzekutimit të penaltive.



SHKURT

Morata: Meritonim shumë më tepër

Sulmuesi Alvaro Morata nuk arriti dot të ishte edhe një herë tjetër vendimtar nga pika e bardhë, edhe pse u duk se do të ishte mbrëmja e tij pas kthesës që i bëri ndeshjes së Spanjës ndaj Italisë kur e barazoi rezultatin 1-1. Ai nuk e ka fshehur zhgënjimin e tij për këtë eliminim të kombëtares së tij. "Ky grup meritonte më shumë, shumë më tepër. Ashtu si e gjithë Spanja, kjo ishte edhe ëndrra ime, ëndrra jonë. Unë mund të them vetëm që jam krenar që isha pjesë e kësaj skuadre. Për të gjithë ata që besuan te ne, faleminderit. Futbolli ndonjëherë mund të jetë i pamëshirshëm. Rroftë Spanja!", ka thënë Morata.

Bonucci: Kjo ishte ndeshja më e zorshme në jetën time

Mbrojtësi Leonardo Bonucci e ka cilësuar fitoren e Italisë kundër Spanjës në gjysmëfinale të "Euro 2020" më të vështirën në karrierën e tij si futbollist. Bonucci u shpreh krenar pas ndeshjes për mënyrën sesi Italia i bëri ballë një Spanje sulmuese dhe tregoi gjakftohtësi në penallti për ta siguruar finalen në kërkim të një trofeu të madh. "Kjo është ndeshja më e vështirë që e kam luajtur. E uroj Spanjën për lojën që tregoi, por përsëri Italia tregoi zemër, përkushtim dhe aftësi për t'i tejkaluar çastet e vështira dhe lotaria e penaltive na shpërbleu. Fitorja për të cilën vuan është gjithmonë më e këndshme", ka thënë Bonucci.

Busquets: Ishim superiorë ndaj Italisë

Spanja është eliminuar në gjysmëfinale të Kampionatit Evropian, pasi u mposht në penallti nga Italia. Koha e rregullt e kësaj ndeshje u mbyll 1-1. Kapiteni i Spanjës, Sergio Busquets, ka thënë se demonstruan që ishin më të mirë se kundërshtarët. "Të gjithë e bënë Italinë favorite të madhe në këtë sfidë, por ne demonstruam se ishim superiorë ndaj tyre. Kemi luajtur me shumë futbollistë të rinj dhe e gjithë kjo përvojë do të shërbejë për t'u dhënë atyre më shumë besim në vete", ka deklaruar Busquets.

Mançini: Spanja një ekip i shkëlqyer, duhet të përgatitemi për finale

Trajneri Roberto Mançini e pranon se Spanja i shkaktoi probleme me ndryshimet taktike dhe Italisë iu desh të punonte shumë që të arrinte në finalen e "Euro 2020" por, sipas tij, ende nuk ka mbaruar asgjë. "Penalltitë

janë mizore. Ishte një kundërshtarë e vështirë. Spanja është një ekip i shkëlqyeshëm që luan shumë mirë. Ne nuk luajtëm siç bëjmë zakonisht, por luftuam fort dhe e dinim se do të ishte kështu. Ata na

shkaktuan probleme me këtë ndryshim, por më pas morëm koordinatat e duhura dhe nuk rrezikuam shumë. Ne e dinim që nga fillimi që Spanja ishte zotëruesja e posedimit, kështu që do të na bënte probleme, por na

duhej të rregullonim dhe të luftonim fort", ka thënë Mançini. "Ekipet e futbollit sulmojnë dhe mbrojnë, nuk mund vetëm të sulmojnë. Të dyja kishim raste, të dyja janë skuadra të shkëlqyera. Të gjitha ekipet mbrojnë, jo

vetëm italianët. Meritat u takojnë djemve, sepse ata besuan në gjithë këto tre vjet, por nuk ka mbaruar ende. Duhet t'i mbledhim ato forca që kanë mbetur dhe të përgatitemi për në finale", ka shtuar Mançini.


Azem Bejta pas 18 vjetësh largohet nga Drenica

SKENDERAJ, 7 KORRIK - Kapitëni legjendar i Drenicës, Azem Bejta, largohet nga kjo skuadër pas plotë 18 vjetësh. Lajmin e ka bërë me dije vetë futbollisti nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook". Futbollisti drenicas e ka vlerësuar momentin e largimit

nga skuadra kuqezi si më të vështirën në jetën e tij. "Pas 18 vjetëve duke mbrojtur stemën e klubit më të mirë, klubit Kuq e Zi, dita më e vështirë në karrierën time sportive ka ardhur. Unë po largohem duke ju falënderuar për gjithçka. Ju e dini se unë kam qenë i dashuruar me

këtë klub dhe kjo nuk ka ndryshuar si në kohë të mira dhe në kohë të këqija. y klub më ka rritur si person, më ka ndihmuar të bëhem ai që kam dashur gjithmonë, të bëhem një futbollist i KF Drenica. Sot dua t'i falënderoj bashkëlojtarët, trajnerët dhe presidentët e klubit.

Faleminderit ju tifozë të dashur që keni rrugëtuar së bashku me mua. Faleminderit të gjithëve për të gjitha! Unë kurrë nuk do t'ju harroj. Unë do të jem gjithmonë tifoz i klubit më të mirë KF Drenica. Ju mund të llogaritni gjithmonë në mua. Faleminderit!", ka shkruar Bejta.



Vraniqi: Po japim maksimumin në stërvitje

PRISHTINË, 7 KORRIK - Kosova U20 është duke vazhduar stërvitjet për garat evropiane që do t'i ketë gjatë verës. Kosova U20 (F) do të marrë pjesë në Grupin E të FIBA U20 Women's European Challengers që do të organizohet në Shkup prej 13 deri më 18 korrik 2021. Basketbollistja e Kosovës, Sara Vraniqi, është shprehur se po japin maksimumin në stërvitje. "Deri më tani përgatitjet kanë shkuar shumë mirë. Ne po japim më të mirën tonë në përgatitje në mënyrë që të jemi sa më të gatshme për garat në Shkup", ka thënë Vraniqi për faqen zyrtare të FBK-së.

Kosova do të luajë në grup me Rumaninë, Sllovakinë, Luksemburgun dhe Maqedoninë e Veriut. "Ne do ta japim maksimumin në çdo ndeshje. Angazhimi ynë nuk do të mungoj dhe shpresojmë se do të bëjmë paraqitje sa më të mira përballë kundërshtarëve që i kemi. Sigurisht



se në çdo sfidë do të luajmë me maksimumin tonë dhe do t'u qasemi ndeshjeve me seriozitetin më të madh, duke shpresuar se do të shënojmë ndonjë fitore në grup", deklaroi basketbollistja e Bashkimit. Kësaj radhe FIBA Kampionatet

Evropiane nuk janë ndarë në Divizione, por në grupe dhe këto grupe do të organizohen në disa shtete. Për shkak të gjendjes me pandeminë Covid-19, nuk do të ketë ngritje në divizione apo edhe rënie në divizione më poshtë.

Phoenixi fiton finalen e parë ndaj Milwaukeees

PHOENIX, 7 KORRIK - Chris Paul merr për dore Phoenix Sunsin në finalen e parë të NBA ndaj Milwaukee Bucksit. Në Arizona, falë edhe paraqitjes fantastike të veteranit Paul, Phoenix arriti të triumfojë lehtësisht me rezultatin 118-105 ndaj ekipit nga Wisconsin duke marrë edhe kryesimin e serisë 1-0 me ndeshje. Finalja e madhe e NBA-s nisi me performancën e lartë nga Phoenix Suns që arriti të merrte frenat e lojës që në dy periodat e para duke shkuar në pushim në avantazhin e 8 pikëve. Falë formës së shkëlqyer të treshes Chris Paul, Davon Booker, DeAndre Ayton, skuadra e drejtuar nga trajneri Monty Williams e thelloi edhe më shumë epërsinë në periodën e 3-të, ndërsa në 12 minutat e fundit të lojës arriti të menaxhonte në mënyrën më të mirë epërsinë duke e mbyllur ndeshjen me shifrat finale



118-105, raporton "Supersport". Chris Paul, më i miri mbi parket për Phoenix Suns, me 32 pikë, 4 rebounde dhe 9 asistime, u mbështet edhe nga Davon Booker, autor i 27 pikëve dhe basketbollistit nga Bahamasi DeAndre Ayton i cili shkëlqeu me 22 pikë dhe 19 rebounde. Te Milwaukee Bucks më i miri mbi parket ishte Khris Middleton me 29 pikë, ndërkohë që

Giannis Antetokounmpo nuk u shfaq në versionin e tij më të mirë, edhe pse greku i Bucksit koleksionoi në total 20 pikë, 17 rikuperime poshtë tabelës dhe 4 asistime. Edhe finalja e dytë e serisë mes Phoenix dhe Milwaukee do të luhet në Arizona pasi në sajë të ecursisë më të mirë gjatë sezonit të rregullt, Suns ka avantazhin e parketit në këtë duel.

SHKURT

Ramadani: Na penalizoi mungesa e përvojës

Trajneri i Prishtinës, Zekerija Ramadani, ka parë mungesën e përvojës si shkak për humbjen nga Ferencvaros në kuadër të rrethit të parë kualifikues në Ligën e Kampionëve. "Për 2/3 e ndeshjes luajtëm mjaft mirë, pastaj gjithçka u hedh në ujë për 10 minuta. Mendoj se për 70 minuta ishim të barabartë me ekipin kundërshtar, kishim ide të qarta për çfarë kishim udhëtuar. Por, ne nuk e kemi përvojën. Është hera e parë që garojmë në këtë garë dhe kjo mjaftojt është arsyeja kryesore e kësaj humbje. Të jem realist, mendoj se pak kemi gjasa në ndeshjen e kthimit, por ne do të japim gjithçka nga vetja", ka thënë Ramadani.

Inzaghi paraqitet tek Interi: Duam ta mbrojmë titullin

Trajneri italian Simone Inzaghi është paraqitur zyrtarisht si tekniku i ri i Interit në sallën e shtypit në stadiumin "Giuseppe Meazza". Ish-trajneri i Lazios bën hapin e madh në karrierë dhe e cilëson Interin si një sfidë e madhe. "Shumë entuziazëm dhe motivim. E di që na pret një punë e rëndësishme, por është e bukur sepse më ka bindur menjëherë. Drejtuesit e kanë treguar që më dëshironin. Synojmë një rrugëtim më të gjatë në Ligën e Kampionëve sepse Interi ka që në vitin 2011 që nuk kalon grupet. Duam të tregojmë vazhdimësi pas titullit kampion. Kemi të gjitha motivimet e duhura që nevojiten", ka thënë Inzaghi.

Nagelsmann: Neueri mbetet kapiten i Bayernit

Trajneri i ri i Bayern Munchenit, Julian Nagelsmann, ka bërë me dije se portieri Manuel Neuer do të mbetet kapiten i skuadrës edhe në të ardhmen. "Manuel Neuer do të mbetet kapiten. Ai është një kapiten i jashtëzakonshëm. E njëjta gjë vlen edhe për këshillin e ekipit. David Alaba u largua. Ne do të emërojmë një lojtar në vend të tij. Këshilli i ekipit siguron që gjërat të diskutohen në një grup më të vogël. Ne do të vazhdojmë në atë mënyrë", ka deklaruar Nagelsmann.

Eriksen, bashkëshortja e tij dhe mjekët që i shpëtuan jetën ftohen për të parë finalen e 'Euro 2020'

Christian Eriksen, bashkëshortja e tij dhe gjashtë mjekët që i shpëtuan jetën futbollistit, janë ftuar nga UEFA në finalen e "Euro 2020" që do të luhet të dielën, në "Wembley". Agjenti i futbollistit të Interit, Martin Schoots, ka thënë për "Sportsmail": "Christian ndihet ende pjesë e ekipit. Danimarka është vend i vogël dhe lidhja mes lojtarëve është shumë e ngushtë". Ende nuk ka konfirmim nëse Eriksen do të jetë në Londër, ndërsa 6 mjekët e kanë pranuar ftesën tashmë.

Argjentina - Brazili, finalja e Kupës së Amerikës

Përveç Kampionatit Evropian, ku sot do të mësohet finalja e "Euro 2020", në një garë tjetër si ajo e Kupës së Amerikës veçse janë konfirmuar dy kombëtaret finaliste.

Mbrëmë u zhvillua gjysmëfinalja e dytë e këtij kompeticioni, ku Argjentina e mposhti Kolumbinë në penallti, pasi që në kohën e rregullt u ndanë me barazim 1-1. Në anën tjetër, Brazili e

eliminon me rezultat minimal 1-0 Perunë, ku golin e vetëm të ndeshjes e shënoi mesfushori i Lyonit, Lucas Paqueta. Në rrugëtimin e tyre deri në finale, Argjentina në çerekfinale e mposhti

Ekuadorin me rezultat 3-0, kurse Brazili me rezultat 1-0 e eliminon Kilin. Në fazën e gjysmëfinales, Argjentina e eliminon Kolumbinë përmes penalltive, kurse Brazili e mposhti Perunë me rezultat

minimal 1-0. Pasi që finalja është konfirmuar, ndeshja për vend të tretë do të jetë në mes të Kolumbisë dhe Perusë e cila zhvillohet më 10 korrik, derisa finalja zhvillohet më 11 korrik.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2021 të datës 26 Mars 2021, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS

I. Zyrtar Ligjor 2,
Prokuroria Themelore Prishtinë, katër (4) pozita

Referenca:	KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 009
Emri pozitës:	Zyrtar Ligjor 2
Pozita:	Pozitë e karrierës
Kategoria funksionale:	Profesional 2
Grada:	9
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë
Kodi punës:	LI/060
Numri i pozitave:	Katër (4) pozita
Koeficienti:	Shtatë (7)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna Provuese:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi :	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

- Ndërmerr të gjitha veprimet konkrete dhe iniciativa profesionale për kryerjen sa më efektive dhe kualitative të punëve të Prokurorit duke i ofruar mbështetje profesionale juridike në hartimin e akteve, shkresave dhe daktilografimin e tyre si dhe mbajtjen e evidencave për lëndët në proces dhe të kryera nga Prokurori e në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Shkrimores së Prokurorisë dhe Udhëheqësin e Administratës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Ndihmon në mënyrë profesionale Prokurorin me daktilografim profesional të akteve që i nxjerrë prokurori lidhur me lëndët konkrete të besuara për ndërmarrjen e veprimeve akuzuese nga prokurori;
- Pranon lëndët e ndara për prokurorin me të cilin punon, evidentimin e tyre në mënyrë elektronike dërgimin e lëndëve me shkresat përcjellëse në shkrimore, mbajtjen e evidencës për lëndët në proces dhe lëndët e kryera, raporton për punën e vet të Udhëheqësi i Administratës;
- Merr pjesë në procesin e dëgjimit të palëve duke e mbajtur procesverbalin e marrjes në pyetje, ruan konfidencialitetin e lëndës dhe palëve;
- Kryen të gjitha punët përgatitore për praninë e palëve para prokurorit me dërgesën e ftesave dhe pranimin e konfirmimeve nga dorëzuesit e shkresave;
- Gjithnjë kujdeset për informimin e Prokurorit lidhur me praninë e tij në gjykime, duke mos e lënë anash informimin lidhur me shkresat e ndryshme apo (corpora deliktet) që ndërliiden me lëndën gjyqësore;
- Përgjegjës për kryerjen e punës në mënyrë sa më profesionale, duke u kujdesur që gjatë punës së besuar të ketë sa më pak lëshime;
- Për punën e vet i përgjigjet udhëheqësit të administratës, ndërsa për punën e kryer me prokurorin lidhur me lëndët mbanë edhe përgjegjësi tek prokurori i çështjes, andaj kërkohet një sy çelësi dhe

vëmendje e veçantë;

- I obliguar të respektojë Kodin e Etikës Profesionale të stafit mbështetës dhe Kodin e Shërbimit Civil;
- Kryen edhe punë tjera që ndërliiden me pozitën e tij/saj duke i zëvendësuar kolegët tjerë në punë;

Njohuritë, shkathësitë aftësitë për vendin e punës:

- Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi juridik dhe administratë publike;
- Njohuri të mirë të gjuhës shqipe, dhe/ose serbe e dëshirueshme, në të shprehur me gojë dhe me shkrim duke përfshirë aftësi të zhvilluara në hartimin e dokumenteve;
- Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj.) dhe internetin;
- Shkathësi për shqyrtimin e lëndëve, aktakuzave dhe shkresave tjera të nevojshme;
- I/E gatshëm/e të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
- Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;
- Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

- Diplomë universitare, Fakulteti Juridik.

Përvoja e Punës:

- 1 vit përvojë pune profesionale.

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data **08.07.2021 deri me datë 22.07.2021** si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- **Aplikimi përmes postës:** Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- **Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**
- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
- Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
